

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

NDËRMJET

**MINISTRISË SË ARSIMIT DHE SPORTIT
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

DHE

**MINISTRISË SË DIASPORËS
SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

DHE

**MINISTRISË SË ARSIMIT,
SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË
SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

**PËR ORGANIZIMIN E PËRBASHKËT TË MËSIMIT
TË GJUHËS SHQIPE DHE TË KULTURËS
SHQIPTARE NË DIASPORË DHE NË MERGATË**

Ministria e Arsimit dhe Sportit e Republikës së Shqipërisë, Ministria e Diasporës e Republikës së Kosovës dhe Ministria e Arsimit e Shkencës dhe Teknologjisë e Republikës së Kosovës, këtu e më tutje të referuara si Palë, në Mbledhjen e Përbashkët të dy Qeverive të mbajtur më 23 mars 2015 në Tiranë, Republika e Shqipërisë;

Bazuar në nenet 2 dhe 3 të Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, nënshkruar më 19 qershor 2008, si dhe në Protokollin e sesionit të parë të Komisionit të Përbashkët Ndërqeveritar për Bashkëpunimin Kosovë- Shqipëri, i nënshkruar më 15 mars 2013;

Duke pasur parasysh vlerat dhe interesat e përafërta, si dhe duke i konsideruar nevojat e përbashkëta për organizimin e mësimit për gjuhën shqipe dhe kulturën shqiptare në diasporë;

Duke vlerësuar se mërgata shqiptare është një dhe e pandarë;

Duke konsideruar angazhimin dhe interesin e përbashkët për mbështetjen e mërgatës në ruajtjen, zhvillimin dhe promovimin e identitetit kulturor, gjuhësor dhe arsimor;

Kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje Bashkëpunimi është organizimi i mësimit të gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare në mërgatë.

Neni 2 Fushëveprimi

1. Organizimi i përbashkët i mësimit të gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në diasporë realizohet në përputhje me legjislacionin e shteteve bashkëorganizuese dhe të shtetit në të cilin organizohet mësimi i gjuhës shqipe dhe i kulturës shqiptare në mërgatë.
2. Organizimi i përbashkët i mësimit të gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare në mërgatë realizohet me anë të:
 1. Harmonizimit të legjislacioneve përkatëse;
 2. Hartimit të kurrikulave dhe të teksteve mësimore të unifikuara;
 3. Përcaktimit të standardeve të përbashkëta të rekrutimit të mësuesve;
 4. Bashkëfinancimit të projekteve dhe të programeve të miratuara nga institucionet përgjegjëse të palëve;
 5. Organizimit të përbashkët të fushatave sensibilizuese dhe promovimit të aktiviteteve të përbashkëta.

Neni 3 Përfituesit

1. Fëmijët shqiptarë në mërgatë janë përfituesit e mësimit të gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare.
2. Palët bien dakord që nga ky organizim i përbashkët të përfitojnë nxënësit shqiptarë dhe të gjithë nxënësit e tjerë të shkollave përkatëse të interesuar për gjuhën shqipe dhe për kulturën shqiptare.

Neni 4 Harmonizimi i legjislacioneve

Palët bien dakord të angazhohen të harmonizojnë legjislacionet e tyre përkatëse, me qëllim organizimin e përbashkët të mësimit të gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare në mërgatë.

Neni 5 Kurrikula e përbashkët

Palët bien dakord për hartimin e kurrikulës së përbashkët nga Ministritë e Arsimit, e cila do të zbatohet nga shkollat e mësimit të gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare në mërgatë.

Neni 6 Kualifikimi i mësimeve

Mësimeve që do të angazhohen në mësimin e gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare, duhet të kenë diplomë universitare në profilet përkatëse, si dhe të jenë të licencuar sipas legjislacioneve përkatëse nga palët. Përparësi kanë kandidatët e diplomuar në degët si në vijim ose të ngjashme: Gjuhë shqipe e letërsi, parashkollor, cikël i ulët (arsimi fillor), histori, gjeografi (histori-gjeografi), etnologji, muzikë dhe arte të hapësirës shqiptare.

Neni 7 Procedura e rekrutimit

1. Pranimi i mësimeve në këto shkolla do të bëhet sipas procedurave dhe kriterëve të konkurrimit:
 - a) Kushtet dhe kriteret e konkursit bëhen në përputhje me specifikat e shtetit ku organizohet mësimi;
 - b) Kriteret për përzgjedhjen e personelit arsimor do të caktohen në mënyrë unike nga Palët;
 - c) Kontrata e punës e mësuesit lëshohet nga vendi prej nga vjen mësimeve, bazuar në përqindjen e numrit të mësimeve;
 - d) Përgjegjësinë për përzgjedhjen e mësimeve do ta kenë institucionet përkatëse të Palëve të kësaj marrëveshjeje.

2. Për të qenë mësime në mësimin e gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare, të drejtë konkurrimi kanë kandidatët nga Kosova, Shqipëria, si dhe kandidatë të tjerë të cilët i plotësojnë kriteret e përcaktuara në këtë Marrëveshje dhe në legjislacionin përkatës të Palëve.

Neni 8 Financimi

1. Pagesa e mësimeve (ku do të përfshihen ndalesat) bëhet si në vijim:
 - a) Në rastet kur përbërja e nxënësve në klasë, të shtetit nga është mësuesi, është më tepër se 30% e numrit të nxënësve në klasë, pagesa e mësuesit do të bëhet 50% me 50% nga secila Palë.
 - b) Kur përbërja e nxënësve në klasë, të shtetit nga është mësuesi, është nën 30% e numrit të përgjithshëm të nxënësve, pagesa e mësuesit bëhet nga Pala tjetër.
2. Shpenzimet e organizimit të seminareve për trajnimin dhe kualifikimin e mësimeve që japin mësim në këto shkolla, mbulohen me 50% nga secila Palë.
3. Tekstet dhe mjetet mësimore dhe dokumentacioni shkollor sigurohen nga buxheti i Palëve, duke u bazuar në numrin e nxënësve, numrin e klasave dhe numrin e shkollave.
4. Financimi i aktiviteteve të përcaktuara në nenin 9 të kësaj Marrëveshjeje bëhet me 50% nga secila Palë.
5. Për zbatimin e këtij neni, palët zotohen që do të arrijnë Protokoll Zbatimi përmes grupeve të parapara me nenin 11.1, i cili do të kalojë nëpër procedurat e brendshme në përputhje me legjislacionin e brendshëm të palëve.

Neni 9 Nisma dhe lidhja e marrëveshjeve me shtetet e treta

1. Palët bien dakord që në varësi nga numri i nxënësve që pritet të marrin pjesë në mësimin e gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare, të angazhohen për nismën, përkatësisht për lidhjen e marrëveshjeve me shtetet ku do të bëhet organizimi i mësimit.
2. Në këto marrëveshje, secila palë merr përsipër të përfshijë si përfitues edhe nxënësit e palës tjetër.

Neni 10 Organizimi i fushatave sensibilizuese

Palët pajtohen të angazhohen për organizimin e përbashkët të fushatave sensibilizuese, promovimin e aktiviteteve të përbashkëta, botimin e revistave të përbashkëta, transmetimin e incizimeve promovuese, botimin e broshurave dhe të pllakateve (posterave), organizimin e përbashkët të emisioneve në medime për mësimin plotësues në mërgatë etj.

Neni 11
Zbatimi i Marrëveshjes

1. Palët bien dakord të krijojnë grupe të përbashkëta pune për të përcaktuar dinamikën e zbatimit të detyrimeve që lindin nga kjo Marrëveshje.
2. Palët pajtohen se dinamika nga neni 11 pika 1 e kësaj Marrëveshjeje, duhet të përfshijë së paku një periudhë trevjeçare, pas së cilës Marrëveshja fillon të zbatohet në tërësinë e saj.
3. Për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, Palët bashkërisht do të caktojnë një përgjegjës që të kujdeset për mbarëvajtjen e procesit mësimor në shtetin ku organizohet mësimi.

Neni 12
Hyrja në fuqi

1. Kjo Marrëveshje hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të saj nga Palët.
2. Marrëveshja mund të ndryshohet nëpërmjet negociatave dhe miratimit të ndërsjellë të Palëve.

Bërë në Tiranë, më 23 mars 2015 në dy kopje origjinale në gjuhën shqipe, ku të gjithë tekstet janë njëloj të vlefshëm.


PËR MINISTRINË E ARSIMIT DHE SPORTIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Znj. Lindita MKOLLA



PËR MINISTRINË E DIASPORËS TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Z. Valon MURATI



PËR MINISTRINË E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Z. Arsim BAJRAMI

